



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A**

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Data \_\_\_\_\_

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**“Shpim Puse Uji, 2 puse”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Punime ndërtimi për puse 45255110-3

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**8,888,795** (tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **“Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier” Sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

---

(Shënim: përcaktimi **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së parashikuar të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe në nenin 77 pika 3 i LPP, si dhe nenin 43 pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

---

**2.2.2** Kopje të vërtetuar të bilancit për 2(dy) vitet e fundit financiare, të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2022**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. **Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

**2.2.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë analizë çmimi të detajuar për të gjithë zërat e shërbimeve në preventive (kjo vlen edhe në rastet e bashkimit të operatorëve, secili operator sipas përqindjes së shërbimit që do të kryej dhe të kontratës së bashkëpunimit).

**Argumentimi:** Pika 2.2.4 është vendosur bazuar në VKM nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (i ndryshuar).

## 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

### 2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon:

- i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.  
Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

➤ Për të vërtetuar përvojën e ngjashme, OE duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Kontratën e Sipërmarrjes,
- Situacion përfundimtar të objektit,
- Aktin e Kolaudimit të objektit ose Çertifikatë përfundimi (kur është me financim të huaj).
- Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9 të DST ose fatura tatimore në rast të punëve në sektorin privat.
- Licenca profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:
  - a) Licenca për zbatim punimesh “Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë” pika N.S.20 – Klasifikimi “A”.

**Arsyetimi:** Pika 2.3.1 është vendosur bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020 “Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 1 gërma “c”; në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 55 pika 4/“a” si dhe përcaktimi i Licencës N.S.20 – Klasifikimi “A” mbështetur në VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
Punime Speciale Ndërtimi	<b>Vendim Nr.42, datë 16.1.2008</b> “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave	Shpim i pusit me diameter 470mm Shpim i pusit me diameter 311mm F.V tubo celiku me diametër 300mm F.V tubo te galvanizura	N.S.- 20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.	

	profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”-Lidhja 2	me diametër 200 Prgatitje argjile bentonite Mbushje e trungut të pusit me zhavor Larje pusi zevendesimi i argjiles me uje Betonim pusi ne grykes <i>se pusit B/ M 150</i> Pompim testim pusi me kompresor Analiza kimike te ujit Analiza Bakteorologjike uji Brryl dalje fllanxhe ø 200 + 1nl tub DN80mm F.V. Fllanxhe ø200mm celiku PN 10 bar		
--	--	--	--	--

### 2.3.2 Shoqëria duhet të ketë në stafin e saj inxhinierat si më poshtë:

- Inxhinier Shpimi (pranohet edhe mundësia e kontraktimit). Ai duhet të jetë kompetent për përballimin e humbjeve në zonat me shpime, kur kemi fenomene të gaverizimit (theksojmë që kemi të bëjmë me pus dublant).
- Inxhinier Hidrogjeolog, i cili përcakton litologjinë e horizontit ujë-mbajtës dhe përballimin e humbjeve nga ana gjeologjike.
- 2 manovrator dhe 1 vincier

Operatori ekonomik duhet të paraqesë CV ku të tregohet eksperiencia e tij për shpim apo për pastrim pusesh.

Operatori ekonomik duhet të deshmohet se shpuesi është profesionist. Nëse nuk disponon ndonjë dokument, atëherë duhet të paraqesë librezën e punës, ku vërtetohet në këto raste se shpuesi është një kryesondator profesionist i kategorisë së VI.

**Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe bazuar në nenin 26 pika 6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021** (i ndryshuar), *ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Arsyetimi:** Pika 2.3.2 është vendosur bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6/“c”.

### 2.3.3 Numri mesatar i punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit, të jetë jo më i vogël se 5 punonjës të përhershëm për muajt, të punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik,

- Kjo pikë dokumentohet me vërtetim të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve (Degët e Tatimeve) ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore e rrethit perkates ose me vulë elektronike
- Listëpagesat për periudhën e mësipërme (E-sig 25)

**Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe bazuar në nenin 26 pika 6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021** (i ndryshuar), ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

**Arsyetimi:** Pika 2.3.3 është vendosur bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6/“ç”.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qëra **1(një) sondë** me kapacitet ngritës 20 ton, pesha tërheqëse jo më pak se 15 ton, e vërtetuar kjo në çertifikatën e origjinës.

- OE duhet të paraqesi foto të sondës.
- Sondat duhet të jetë Hidraulike e tipit Top-Driver me rrotullim dhe duhet të jetë e pajisur me leje qarkullimi, kolaudimi, siguracioni, çertifikata e pronësisë të jetë në emër të subjektit që oferton. Në rast se nuk e ka në pronësi, të vërtetojë që sondën mund ta ketë me qëra të vërtetuar me dokumentat përkatëse me kohëzgjatje sa periudha e kontratës.

**Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe bazuar në nenin 26 pika 6 të VKM nr.285 datë 19.05.2021** (i ndryshuar), ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, do të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

**Arsyetimi:** Pika 2.3.4 është vendosur bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 39 pika 6/“d”.

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë analizën e çmimeve.

**Arsyetimi:** Pika 2.3.5 është vendosur bazuar në VKM nr.629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (i ndryshuar).

### **2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1.** .....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

➤ SPECIFIKIMET TEKNIKE

❖ Pus dublant shpime për ujë pusi Çi pllakë UKF 23

Nr	Analiza	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	Njësia	Sasia
		<b>Shpimi i pusit</b>		
4	An	Shpim i pusit me diameter 470mm	mI	13
5	An	Shpim i pusit me diameter 311mm	mI	237
6	An	F.V tubo celiku me diametër 300mm	mI	13
7	An	F.V tubo te galvanizura me diametër 200	mI	250
8	An	Pregatitje argjile bentonite	orë	21
9	An	Mbushje e trungut te pusit me zhavor	M3	12
10	An	Larje pusi zevendesimi i argjiles me uje	O.pune	8
11	1.128/1 An	Betonim pusi ne grykes <i>se pusit B/M 150</i>	M3	3.5
12	An	Pompim testim pusi me kompresor	O.pune	24
13	An	Analiza kimike te ujit	cope	1
14	An	Analiza Bakterologjike uji	cope	3
15	An	Bryl dalje flanaxhe ø 200 + 1nl tub DN80mm	cope	1
16	An	F.V. Fllanaxhe ø200mm celiku PN 10 bar	cope	1

❖ Pus dublant, shpime për ujë- pusi XHEPAJ 16

Nr	Analiza	PËRSHKRIMI I PUNIMEVE	Njësia	Sasia
		<b>Shpimi i pusit</b>		
4	An	Shpim i pusit me diameter 470mm	mI	30
5	An	Shpim i pusit me diameter 311mm	mI	186
6	An	F.V tubo celiku me diametër 300mm	mI	30
7	An	F.V tubo te galvanizura me diametër 200	mI	216
8	An	Pregatitje argjile bentonite	orë	18
9	An	Mbushje e trungut te pusit me zhavor	M3	14

10	An	Larje pusi zevendesimi i argjiles me uje	O.pune	8
11	1.128/1 An	Betonim pusi ne grykes <i>se pusit B/ M 150</i>	M3	3.5
12	An	Pompim testim pusi me kompresor	O.pune	24
13	An	Analiza kimike te ujit	cope	1
14	An	Analiza Bakteorologjike uji	cope	3
15	An	Bryl dalje fllanxhe ø 200 + 1nl tub DN80mm	cope	1
16	An	F.V. Fllanxhe ø200mm celiku PN 10 bar	cope	1

• **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

- Pas përfundimit të shpimit pusit, OE duhet të paraqesi raportin hidrogjeologjik të shfrytëzimit të shpimit dhe të shikohet mundësia që pompa zhytëse të mos vendoset në pjesët ku janë filtrat.

**GRAFIKU I PUNIMEVE**

❖ **Grafiku i punimeve të jetë 45 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës.**

**II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik” në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

*NJËSIA E PROKURIMIT*